



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2022

V E N D I M

Nr. 9, datë 10.01.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 226, datë 02.12.2021, të z. I.D., ku pretendohet diskriminim për çdo shkak tjetër, nga ana e z. G.K., Dekan i Fakultetit të Drejtësisë, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër dhe znj. E.B., Drejtor i Departamentit Civil, pranë të njëjtit fakultet.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet e subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, z. I.D. është pedagog/lektor pranë Fakultetit të Drejtësisë, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër që prej vitit 2015. Ankuesi sqaron se që prej datës 22.09.2021, në mënyrë të vazhdueshme, Dekani i Fakultetit të Drejtësisë e ka penguar lidhur me ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me veprimet dhe mosveprimet e tij dhe pa ndonjë shkak të përligjur.

Për sa më sipër, ankuesi sqaron se ka vendosur të konkurojë si kandidat për vendet e shpalluara vakant nga Kuvendi i Shqipërisë, për anëtarë të organeve të drejtësisë, konkretisht në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga trupa e pedagogëve të institucioneve të arsimit të lartë dhe Shkollës së Magjistraturës. Veprimet diskriminuese të Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë ndaj tij kanë konsistuar në faktin, se ky i fundit në cilësinë e titullarit të institucionit arsimor që drejton, pa asnjë shkak ligjor, nuk i ka dërguar dosjet personale të ankuesit për

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

vazhdimin e konkurimit pranë Kuvendit të Shqipërisë. Ankuesi sqaron se në datat 04.10.2021 dhe 07.10.2021, i është drejtuar zyrtarisht me kërkesë, z. G.K., Dekan i Fakultetit të Drejtësisë, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, duke i kërkuar informacion mbi dosjet e tij. Z. I.D. ka paraqitur kërkesë, në datën 04.10.2021, edhe pranë Rektorit të Universitetit. Dekani nuk i është përgjigjur as kërkesave të tij dhe as asaj të Rektorit të Universitetit, duke u përpjekur të favorizojë kandidaturën tjetër të përzgjedhur nga Fakulteti i Drejtësisë.

Gjithësesi vetëm falë ndërhyrjes së Rektorit, dosjet e z. I.D. janë dërguar për vazhdimin e konkurrimit si kandidat për anëtar në KLGJ³ dhe KLP⁴. Z. I.D. sqaron se sipas ligjit nr. 115/2016, nga çdo fakultet mund të dërgohen jo më shumë se 3 (tre) kandidatura dhe në këtë mënyrë, që të favorizohet një kandidaturë tjetër është penguar dërgimi i dosjes së tij. Ankuesi pretendon se në Mbledhjen e Posaçme të Rektorëve të IAL-ve publike dhe private, si dhe Shkollës së Magjistraturës, të zhvilluar në datën 12.10.2021, Dekani G.K. është shprehur kundër kandidaturës së tij për në organet e drejtësisë, si dhe e ka konsideruar kandidat humbës. Ankuesi pretendon se deklaratimet e z. G.K. evidentojnë qartësisht qëllimin e veprimeve diskriminuese ndaj tij. Z. I.D. sqaron gjithashtu se në vijim, veprimet diskriminuese të Dekanit kanë vazhduar ndaj tij dhe janë reflektuar në ndikimin e tij në vendimmarrjen e departamentit ku ai punon, duke i pezulluar ngarkesën mësimore, ndërkohë që sipas dispozitave ligjore këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm Senati Akademik i Universitetit, në rastet kur pedagogu ka kryer shkelje të rënda ose Këshilli i Etikës.

Përveç sa më sipër, ankuesi pretendon se Dekani i Fakultetit të Drejtësisë ka marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbledhjen e Departamentit të së Drejtës Civile, pjesë e së cilit është ankuesi, duke bërë deklaratat fyese dhe denigruese ndaj personalitetit të tij. Në datën 27.10.2021, ankuesi sqaron se ka depozituar kërkesë Departamentit të së Drejtës Civile, si dhe për dijeni Dekanit G.K., nëpërmjet së cilës ka kërkuar kopje të akteve të mbledhjeve të mbajtura në datat 22.10.2021 dhe 26.10.2021. Ai pretendon se këto akte nuk i janë dërguar.

Pretendimi për diskriminim nga ana e znj. E.B., Drejtor i Departamentit Civil, pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër konsiston në faktin se titullarja e këtij departamenti ka marrë vendime që e kanë cënuar ankuesin, vendime, të cilat ai i konsideron të padrejta dhe të dhëna jashtë kompetencave të saj ligjore. Për sa më sipër, ankuesi sqaron se është njoftuar nga ana e saj për një mbledhje në datën 22.10.2021, në të cilën ai nuk ka marrë pjesë për arsye shëndetësore, pasi ishte me raport për paaftësi të përkohshme në punë. Pavarësisht kësaj, mbledhja është zhvilluar dhe ndaj tij është marrë vendim për dërgimin e tij për masë disiplinore në Këshillin e Etikës. Në datën 26.10.2021 është zhvilluar një mbledhje tjetër, ku përveç propozimit për masë disiplinore ndaj tij, është ndërmarrë edhe një tjetër masë për pezullimin e

³ Këshilli i Lartë Gjyqësor;

⁴ Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

ngarkesës mësimore. Ankuesi sqaron se një masë e tillë është e njëjtë me pezullimin nga detyra dhe thekson faktin se kjo masë nuk është kompetencë e drejtorit apo e anëtarëve të departamentit, por e Senatit Akademik të Universitetit ose e Këshillit të Etikës mbi bazën e një procedure vlerësimi nga ky i fundit.

Në datën 27.10.2021, ankuesi pretendon se ka dërguar një kërkesë Drejtorit të Departamentit të së Drejtës Civile, për marrjen e akteve të mbledhjeve të zhvilluara në datat 22.10.2021 dhe 26.10.2021, por këto akte ende nuk i janë dërguar në adresën e tij. Ndërkohë që, në datën 11.11.2021, sërish, pa prezencën e tij, është marrë vendimi për mos miratimin e ngarkesës mësimore për të, deri në marrjen e formës së prerë të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Ankuesi sqaron se ky vendim është marrë në një kohë që pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër nuk ka qenë depozituar asnjë kërkesëpadi, ku ai të ishte në cilësinë e palës ndërgjygjëse. Në këtë vendimmarrje, ankuesi është vënë në dijeni të mbledhjes së datën 19.11.2021, në mënyrë verbale, nga drejtuesja e departamentit.

Në mbledhjen e datës 19.11.2021, ankuesi shprehet se është rishikuar vendimi i marrë në datën 11.11.2021, por duke ndryshuar ngarkesën e tij mësimore dhe duke i hequr lëndën “E drejtë Procedurale Civile”, lëndë në të cilën ai është lektor i parë prej 15 vitesh. Ankuesi thekson faktin se një veprim i tillë është në shkelje të plotë të dispozitave përkatëse të akteve ligjore e nënligjore.

Për sa më sipër, ankuesi kërkon nga KMD, ndërprerjen e veprimeve diskriminuese ndaj tij, si dhe marrjen e masave për t'i rikthyer të gjitha të drejtat dhe pozitën që ka patur para veprimeve diskriminuese të kryera nga ana e subjekteve të sipërcituara. Ankuesi kërkon rikthimin e ngarkesës në lëndët që ka patur para diskriminimit të ndodhur si dhe rikthimin e tij për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve të së drejtës “E drejtë procedurale civile”.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri.

Pas analizimit fillestar, u gjykua që ankesa duhet të plotësohej me informacion të mëtejshëm. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankuesit me e-mail, në datën 03.12.2021, ku iu kërkua informacion plotësues për ankesën lidhur me përcaktimin e saktë të shkakut të diskriminimit nga të dy subjektet, si dhe iu kërkua një kopje e e librezës së punës.

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, ankuesi dërgoi e-mailin e datës 06.12.2021, ku sqaron se: *“Shkaku, për të cilin më pas ka filluar trajtimi diskriminues duke më trajtuar në mënyrë të pa barabartë dhe më pak të favorshme se sa një person tjetër, është për shkak të mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme që kemi në lidhje me mbarëvajtjen e punës në fakultet, ku mund të përmend kërkesat dhe ndërhyrjet abuzive që ai bën për vlerësimet e studentëve që ai i konsideron pranë tij, në lëndën që unë zhvilloj prej 15 vitesh “E drejtë procedurale civile” që pa asnjë shkak të arsyeshëm, siç edhe ju kam parashtruar në ankesën time drejtuar ju, nëpërmjet drejtorit*

të departamentit të të drejtës civile, kanë vendosur që të ma heqin nga ngarkesa mësimore, pavarësisht formimit tim për këtë drejtim.

Mendimet e ndryshme në raport të trajtimit të studentëve, të procesit të mësimdhënies dhe problematikave që shqetësojnë fakultetin e drejtësisë në tërësi, duke mos qënë “krah” me qëndrimet e tij, përbëjnë shkakun e diskriminimit.

Shkaku i mosdakortësisë apo qëndrimeve të kundërta, jo të njëjta me dekanin e fakultetit, janë shoqëruar me qëndrime diskriminuuese, përjashtuese në aktivitetin e fakultetit. Kjo ka kulmuar, me sjelljen diskriminuuese siç edhe kam sqaruar me mbajtjen “peng” në mënyrë abuzive të dosjeve nga ana e tij, në kundërshtim të plotë me ligjin. Kjo me shkak pengimin tim për rritjen time në karrierë.....”

Bashkëlidhur e-mailit të ankuesit, janë dërguar në cilësi prove 3 e-maile, nëpërmjet së cilëve ankuesi është njoftuar për mbledhje të departamentit me rend dite ngarkesën mësimore të pedagogut Ilir I.D., si dhe njoftimin mbi ngarkesën e tij mësimore për vitin akademik 2021-2022.

- Në vijim të përgjigjes së ankuesit, KMD iu drejtua sërish z. I.D., në datën 17.11.2021, nëpërmjet e-mailit zyrtar, ku kërkon informacion, lidhur me provueshmërinë e shkakut të diskriminimit të pretenduar.
- Në datën 19.12.2021, ankuesi dërgoi pranë KMD-së email-in e mëposhtëm, ku sqaron:

“Në raport me çështjet e trajtimit të studentëve dhe procesit të mësimdhënies, komunikimet kryesisht kanë qenë verbale, por mund të paraqes prova të një prej rasteve të fundit që lidhen me një datë provimi (vjeshhtë e vogël) datë 04.10.2021 (Bashkangjitur ndodhet procesverbali i nxjerrë nga sistemi ESSE3), ku për shkak të mos dorëzimit në kohë të proceseve nga ana e Dekanit apo dhe të ndonjë pedagogu tjetër (për këtë duhet marrë informacion pranë Fakultetit të Drejtësisë) vënia në sistem e vlerësimeve është bërë pothuajse gati me një muaj vonesë, pa asnjë shkak të ligjshëm. Për këtë është bërë edhe mbledhje në Rektorat, e cila dokumentohet me emailin e datës 01.11.2021 dërguar nga sekretaria e Rektorit. Por ndërkohë, kam pasur komunikim nëpërmjet email-it ku kam vënë në dijeni edhe drejtorin e departamentit për situatën dhe zgjidhjen e saj ligjore. Bashkangjitur ndodhet emaili i datës 27.10.2021.

Në mbledhjen e datës 01.11.2021 ka pasur diskutime ndërmjet meje dhe kryesisht dekanit për këtë situatë që datonte që në shtator dhe për gjithë periudhën në vijim për qëndrimet dhe korrektesën në punën tonë, gjë e cila nuk ishte hera e parë që ndodhte. Për të provuar që jemi thirrur nga Rektori i USH-së (unë ankues, dekani dhe drejtori i departamentit) paraqes emailin e

datës 01.11.2021 për njoftimin për mbledhje nga Rektori. (Procesverbalin e kësaj mbledhjeje për të provuar diskutimet e bëra nuk e disponoj unë por ai disponohet në Rektorat.)

Po kështu, për të evidentuar qëndrimet e kundërta ndërmjet meje dhe dekanit edhe më parë, mund t'ju vë në dispozicion materiale ndër vite ku evidentohet qartësisht mosdakortësia ime me z. G.K. në lidhje me punën në fakultet. Për këtë, po ju bashkalidh në email: Ankimin e datës 21.09.2015 e protokolluar në Rektorat me Nr. 2926, datë 21.09.2015; Letër e Hapur e datës 29.01.2018 e protokolluar në Rektorat me Nr. 307, datë 29.01.2018;

Në lidhje me shkakun e diskriminimit nga ana e znj. Bisha, ashtu siç edhe ju kam sqaruar në emailin e datës 06.12.2021, për sa i përket veprimeve diskriminuese të znj. Bisha ju bëj me dije se ajo është në koherencë të plotë me qëndrimet dhe kërkesat e dekanit, pasi është e komanduar nga ky i fundit, të cilës edhe pse i ka mbaruar afati i komandimit vijon të qëndrojë në detyrë, kjo me pëlqimin e dekanit. Pikërisht, shkakun e diskriminimit nga ana e drejtorit të departamentit është rrjedhojë e të njëjtit shkak diskriminimi nga ana e dekanit. Në provat e dërguara me emailin e datës 06.12.2021 ju kam vënë në dispozicion tre emaile ku evidentohet qartësisht trajtimi jo i barabartë dhe diskriminues nga drejtori i departamentit kundrejt meje në raport me pedagogët e tjerë, pasi në të gjitha këto mbledhje rend dite ka qenë vetëm ngarkesa mësimore e imja. Po kështu, trajtimi jo i barabartë në këto mbledhje evidentohet edhe në përcaktimin e ngarkesës time me vendimmarrje të departamentit, ndërsa për pedagogët e tjerë një gjë e tillë nuk ndodh (pra nuk bëhet me vendim të mbledhjes të departamentit por vetëm nga drejtori i departamentit).

Në vijim të komunikimit me ju, sa unë ngre si pretendim për diskriminim nga ana e Dekanit z. G.K. dhe znj. E.B., përveç se në parashikimet e ligjit 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (i ndryshuar), gjenë mbështetje edhe në Kodin e Punës neni 9 pika 2 e tij ku përcaktohet "...2. Me "diskriminim" kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet, ...në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët..." si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-ë) ku në nenin 14 - Ndalimi i diskriminimit, të kësaj konvente përcaktohet se: "Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër..."

Bashkëlidhur e-mailit të sipërcituar janë dërguar edhe aktet: Printim nga sistemi-Lista e studentëve të regjistruar (Detaje provimi në: E Drejta Procedurale Civile), e-mail me lëndë "Mbi çështjen e provimit të datës 04.10.2021", drejtuar znj. E.B., Drejtore e Departamentit Civil, printim të e-mailit të datës 11.01.2021, nëpërmjet së cilit ankuesi jep konfirmimin e tij për mbledhje në Rektorat në datën 01.11.2021, shkresa e datës 21.09.2015, e z. I.D. drejtuar Rektorit

të Universitetit të Shkodrës, Letër e Hapur e datës 29.01.2018 e protokolluar në Rektorat me nr. 307, datë 29.01.2018, drejtuar Rektorit të Universitetit të Shkodrës.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për “*çdo shkak tjetër*” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pikat 1, gërma c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankuesi ka përcaktuar si shkak diskriminimi opsionin “për çdo shkak tjetër”. Në këtë kontekst, LMD, i ndryshuar, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁵. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh, për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në këtë dispozitë.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁶.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e saj.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat, që kanë si bazë ose për arsye, një karakteristikë personale, që e bën të dallueshëm një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera, që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

Për sa më sipër, ankuesi ka cilësuar si shkak diskriminimi *“Mendimet e ndryshme në raport me trajtimin e studentëve, procesin e mësimdhënies dhe problematikave, që shqetësojnë Fakultetin e Drejtësisë në tërësi, duke mos qënë “krah” me qëndrimet e tij, përbëjnë shkakun e diskriminimit”*. Ndërmjet të tjerave, Z. I.D. ka depozituar në cilësi prove pranë Komisionerit,

⁵ Neni 1, i ligjit 10221/2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁶ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

shkresën e datës 21.09.2015, drejtuar Rektorit të Universitetit të Shkodrës, si dhe shkresën nr. 307, datë 29.01.2018, “Letër e Hapur”, drejtuar Rektorit të Universitetit të Shkodrës.

Nëpërmjet shkresës së datës 21.09.2015, me lëndë “Ankim mbi problematikat në procesin e testimit në Fakultetin e Drejtësisë”, Komisioneri konstatoi se nëpërmjet saj, ankuesi ka bërë me dije Rektorin e Universitetit të Shkodrës, lidhur me disa problematika që ai ka evidentuar në procesin e testimit të studentëve në datën 18.09.2015. Në këtë shkresë, ankuesi sqaron se disa momente para se të fillonte provimi, nga ana e Sekretarisë Mësimore i është komunikuar fakti se të gjithë studentët pavarësisht pjesëmarrjes do të futeshin në provim, duke iu referuar një shkresë të ardhur nga Dekani i Fakultetit të Drejtësisë. Ankuesi thekson faktin se Dekani i fakultetit ka ndërhyrë në Sekretarinë Mësimore duke dhënë një urdhër në kundërshtim me atë që Rektori i kishte komunikuar atij. Sipas ankuesit, Dekani i Fakultetit të Drejtësisë është shprehur me deklaratë kërcënuese ndaj tij, e cila përfshinte një shprehje krejt të qartë: “.....unë i kryej punët ndryshe dhe jo si disa që rrahin dhe gjakosin, unë i vras...”. Në këtë shkresë ankuesi shprehet se: “Në të vërtetë nuk mu besua një kërcënim i tillë, i cili u përsërit edhe një herë tjetër”. Ajo që më shqetëson më shumë, nuk është fakti se një person i tillë bën apo nuk bën një veprim të tillë, pasi nëse është e thënë që fëmijët e mi të rriten pa babain e tyre, atëherë ashtu qoftë, por pozita e zyrtarit nga e cila e bën, ndërkohë që punojmë në një institucion që supozohet që duhet të përhapë dije që lidhen me konceptin e së drejtës dhe drejtësinë e zgjidhjeve të çështjeve dhe jo nëpërmjet dhunës”. Në këtë shkresë, ankuesi referon se Fakulteti i Drejtësisë në Shkodër paraqet problematika të tjera në lidhje me studentët që nuk frekuentojnë mësimin e etj. në përmbyllje të shkresës, ankuesi kërkon nga Rektori i Universitetit të Shkodrës, si vijon: “I nderuar z. Rektor i Universitetit të Shkodrës, ju drejtohem duke ju kërkuar mbajtjen e një qendrimi në përputhje me ligjin dhe vetëm me ligjin dhe rregulloren e e USH-së, që të ndërhyri me autoritetin që keni në këtë situatë paligjshmërie, duke e vendosur në gjendje ligjshmërie. Kuptohet që kërkesën për qendrimin tuaj, e drejtoj të paktën për pjesën e raporteve të punës, pasi çëshjen e kërcënimit me jetë e kuptoj shumë mirë se nuk mund ta zgjidhni as ju dhe as organi i prokurorisë këtu në Shkodër”.

Përveç shkresës së sipërcituar, edhe në shkresën nr. 307, datë 29.01.2018, të z. I.D., me lëndë “Letër e hapur” drejtuar Rektorit të Universitetit të Shkodrës reflektohen shqetësimet e tij mbi gjendjen dhe ecurinë e provimeve të muajit janar 2018, në lidhje me sekretimin e testeve të provimeve të pedagogëve të tjerë, mbi të cilën ai shpreh mosdakordësinë e tij, duke theksuar faktin se një gjë e tillë bie ndesh me parashikimet e Rregullores së USH. Në këtë shkresë citohet gjithashtu se: “Ky është një shqetësim i vogël në raport me zhvillimet deri në fund të ditës për datën 25.01.2018, ku nga z. G.K. jam kërcënuar personalisht dhe njëkohësisht me familje në prezencë të drejtorit të departamentit S.B., njëkohësisht edhe pjesë e bordit të etikës së USH-së... Por, të vetmet fjalë ishin kërcënim me jetë i imi dhe në drejtim të familjes si dhe fjalë të tjera...”.

Në dy shkresat e sipërcituara rezulton se ankuesi ka shprehur problematikat e tij me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, ndërkohë që në cilësi prove nuk është dërguar asnjë vendimmarrje e Rektorit për shqetësimet e ngritura nga z. I.D.. Komisioneri nuk disponon asnjë praktikë, ku të jetë hetuar nga ana e Rektorit të Universitetit të Shkodrës, mbi problematikat e ngritur nga ankuesi, si dhe të jetë arritur në një vendimmarrje. Njëkohësisht, Komisioneri konstatoi se ankuesi nuk ka depozituar asnjë shkresë apo akt tjetër, ku Dekani i Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit të Shkodrës të ketë shprehur pakënaqësi apo të ketë cekur konflikte të patura me z. I.D., lidhur me çështje që kanë lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se kur ekziston një konflikt midis dy ose më shumë palëve, të gjithë palët e shprehin mosdakordësinë e tyre mbi çështje të caktuara. Në këtë kontekst, Komisioneri ka konstatuar problematika dhe mosdakordësi të ankuesit me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, lidhur me çështje të ndryshme, të cilat janë shprehur qartë në shkresat e sipërcituara. Ndërkohë që, nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë akt në cilësi prove, ku të reflektohet reagimi zyrtar i Dekanit lidhur me këto konflikte apo mosdakordësi me ankuesin.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se konflikti apo mosdakordësia ndërmjet palëve, lidhur me shkakun e pretenduar të diskriminimit, është vërtetuar në mënyrë të njëanshme.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se shkaku i diskriminimit të pretenduar nga ankuesi për Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër rezulton i paprovuar.

Shkaku i diskriminimit të pretenduar nga ankuesi ndaj Drejtores së Departamentit Civil, pranë të njëjtit fakultet është i lidhur me shkakun e diskriminimit të pretenduar ndaj Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë. Ankuesi ka pretenduar se “*shkaku i diskriminimit nga ana e drejtorit të departamentit është rrjedhojë e të njëjtit shkak diskriminimi nga ana e dekanit*”, që kupton se ndikimi i Dekanit tek Drejtori i Departamentit ka qenë vendimtar ndaj veprimeve të ndërmarra ndaj ankuesit. Ndikimi i Dekanit tek Drejtuesja e Departamentit sqarohet nga z. I.D. me arsyetimin se znj. Bisha është në koherencë të plotë me qëndrimet dhe kërkesat e dekanit, pasi është e komanduar në detyrë nga ky i fundit, si dhe thekson faktin se edhe pse i ka mbaruar afati i komandimit vijon të qëndrojë në detyrë, me pëlqimin e dekanit.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se sipas nenit 42 paragrafi 9 i Ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, në rastin e emërimit (komandimit) të Drejtuesit të njësisë bazë (Drejtuesit të Departamentit), nuk është vetëm emërim i Dekanit, por një propozim i Dekanit dhe caktim i Rektorit të Universitetit. Pra, komandimi nuk është tagër absolut i Dekanit, por kërkon një bashkëpunim midis Dekanit dhe Rektorit të Universitetit. Në këtë kuptim, meqenëse të gjitha veprimet e pretenduara si të paligjshme nga ankuesit janë të Drejtueses së Departamentit dhe jo të Dekanit, dhe ankesa i referohet një konflikti të prezumuar të ankuesit me Dekanin,

Komisioneri nuk arrin të kuptojë një lidhje midis veprimeve të pretenduara dhe konfliktit të prezumuar, si shkak me karakteristika të veçanta për tu klasifikuar si shkak diskriminues sipas parashikimit “për çdo shkak tjetër”, të nenit 1 LMD.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se ankesa nuk pranohet kur: “është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankesa e z. I.D. nuk pranohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, nenin 12-13, pika 2, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 226, datë 02.12.2021, të z. I.D., pasi është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – Punësim
Shkak – çdo shkak tjetër
Lloji i vendimit - mospranim